



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i Modullit: **INTERPRETIM SIMULTAN A-B dhe B-A** (sipas KSHK 7, Kualifikim për të nxënësit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë, nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime.

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

Kohëzgjatja e programit të modullit: 30 orë

Nr. i krediteve: 3 ECTS

Mënyra e zhvillimit: Orë praktike në laboratorin e interpretimit

REZULTATET E TË NXËNIT: Ky modul synon t’u mundësojë interpretëve të përmirësojnë aftësitë e tyre teknike, aftësinë për të reaguar shpejt, menaxhimin e stresit dhe të presionit, duke ruajtur njëkohësisht standarde të larta etike dhe profesionale. Këto objektiva synojnë t’i bëjnë interpretët më të aftë dhe të gatshëm për t’u përshtatur në kontekste të ndryshme profesionale.

Përmes formimit të vazhduar në interpretimin simultan, pjesëmarrësit zhvillojnë aftësinë për të interpretuar në mënyrë të shpejtë dhe të saktë në kohë reale. Ata përmirësojnë përqendrimin, duke qenë në gjendje të dëgjojnë, të kuptojnë dhe të përkthejnë njëkohësisht. Gjithashtu, fuqizojnë kujtesën afatshkurtër për të ruajtur dhe përpunuar informacionin pa humbur koherencën e mesazhit.

OBJEKTIVAT E MODULLIT:

- Të zhvillojë aftësinë për të interpretuar në kohë reale me saktësi dhe koherencë.
- Të përmirësojë përqendrimin gjatë proceseve të dëgjimit, analizës dhe rishprehjes në gjuhën e synuar.
- Të forcojë kujtesën afatshkurtër për të ruajtur dhe transmetuar informacionin pa humbje kuptimore.
- Të mësojë teknika për menaxhimin e stresit dhe ruajtjen e qetësisë gjatë interpretimit.
- Të zhvillojë ndjeshmërinë kulturore për të siguruar interpretim të përshtatshëm në kontekstin ndërkulturor.
- Të zhvillojë strategji të avancuara të interpretimit simultan nëpërmjet simulimeve dhe praktikave të drejtpërdrejta.
- Të rrisë aftësinë për t’u përshtatur me folës të ndryshëm, thekse dhe ritme të folurit.

KONCEPTET KRYESORE:

1. Përdorimi i internetit dhe i referencave të BE-së në përgatitjen për në konferencë
2. Përkthimi me të parë.
3. Aftësia për të dëgjuar, kuptuar dhe përkthyer njëkohësisht
4. Memorizimi dhe përpunimi i informacionit të përkohshëm gjatë interpretimit
5. Strategjitë e riformulimit në interpretimin simultan
6. Ndjeshmëria kulturore – kuptimi dhe respektimi i kontekstit kulturor gjatë përkthimit.
7. Parashikimi dhe pararendja në interpretimin simultan



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- | |
|--|
| <p>8. Vlerësimi i performancës së interpretit simultan</p> <p>9. Kodi i etikës dhe reflektimi pas konferencës</p> <p>10. Të folurit publik dhe menaxhimi i stresit</p> |
|--|